



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 08.08.2017

Ref.: 654/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa nr.542/17, datë 22.07.2017 e BPrAL Kolegji ISPE për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.550/17, datë 06.07.2017 si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.555/17, datë 06.07.2017.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji ISPE më 26.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 555/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim BPrAL Kolegjit ISPE i është refuzuar kërkesa për ri/akreditim për këto programe të studimit: Studime të Integruara Evropiane, BA (180 ECTS); Gazetari, BA, 180 ECTS; Marketing dhe Menaxhment Financiar, MA, 120 ECTS; Psikologji, BA, 180 ECTS; Shkenca Kompjuterike, BA, 180 ECTS; Gjuhë Angleze dhe Interpretim, BA, 180 ECTS; Studime Evropiane, MA, 120 ECTS, (me specializime: Integritime Ekonomike Evropiane; Politikat e BE-së).

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji ISPE, është konstatuar që institucioni në fjalë nuk ka sjellë asnjë argument i cili do të mund të merrej në konsideratë nga KSHC.

Në vendimin e KSHC-së për refuzim janë paraqitur të gjitha faktet për secilin program të studimit duke i ju referuar nga pika 1 – 7. Vendimi i KSHC-së për refuzim të aplikacionit për ri/akreditim është marr duke u bazuar në të dhënat faktike pas verifikimit të stafit akademik për secilin program të studimit.

Aprovimi formal i aplikacionit të Institucioneve të Arsimit të Lartë është paraparë në nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016. Në nenin 13, pika 1.1 nder të tjera

thuhet: "Nëse raporti i vlerësimeve preliminare është negativ, aplikacioni do të refuzohet", dhe bazuar në këtë dispozitë, KSHC ne mbledhjen e mbajtur me 23 qershor 2017 ka refuzuar kërkesën e Kolegjit ISPE për ri/akreditim.

Kolegji ISPE bashkë me kërkesën për rishqyrtim të vendimit për pezullim të akreditimit ka dorëzuar edhe një listë (një faqe) me emrat e stafit akademik si bartës të programeve (40 emra) nga të cilët sipas kësaj liste, ndër të tjera, 20 janë pa nostrifikim të diplomës dhe 10 nga ta nuk kanë leje qëndrim të Republikës së Kosovës. Kjo listë konfirmon gjendjen faktike të institucionit në bazë të së cilës KSHC ka marr vendim për refuzim te aplikacionit.

Bazuar në dispozitat ligjore të cekura më sipër, dhe asaj që u cek më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "ISPE";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

